



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.109, datë 30.10.2020

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT SI REZULTAT I DËMIT TË SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR (DEMOLIMI) E PALLATIT “KASTRATI GROUP” DHE DËRGIMIN E SAJ PRANË INSTITUCIONEVE PËRKATËSE PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË MËTEJSHME

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, të neneve 608 e vijues dhe 640 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, VKM nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Vendimit nr.1, datë 07.01.2020 i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Raportit përmbledhës hartuar nga Grupi i punës ngritur me Urdhërin nr. 312, datë 06.10.2020 miratuar nga titullari i institucionit dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit si rezultat i dëmit të shkaktuar nga prishja e detyruar (demolimi) e pallatit “Kastrati Group” në lagjen nr. 17, Rruga “Dalip Peza”, dëmtuar nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, si më poshtë
 - Banesë 1 KT me nr.pas 5/594, zona kadastrale 8513, me pronar Hamdi Lama, me vendndodhje Lagja nr.17.


- Banesë 1 KT me nr.pas 5/178, zona kadastrale 8513, me pronar Krenar Jaçe, me vendndodhje Lagja nr.17.
 - Banesë 1 KT me nr.pas 5/182, zona kadastrale 8513, me pronar Shpresa Nonaj, me vendndodhje Lagja nr.17.
 - Banesë 2 KT me nr.pas 5/181, zona kadastrale 8513, me pronar, Stefanaq Çelo, me vendndodhje Lagja nr.17.
 - Banesë 2 KT me nr.pas 5/1006, zona kadastrale 8513, me pronar, Dhimitraq Peçi, me vendndodhje Lagja nr.17.
2. Dërgimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit si rezultat i dëmit të shkaktuar nga prishja e detyruar (demolimi) e pallatit “Kastrati Group” në lagjen nr. 17, Rruga “Dalip Peza”, si dhe dokumentacionin shoqërues pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, duke kërkuar hartimin e PDyV pikësore përkatëse dhe pranë Komisionit Shtetëror të Rindërtimit duke kërkuar rindërtimin e tyre në të njëjtin truall dhe me të njëjtën sipërfaqe ndërtimi nga Njësia Zbatuese, duke respektuar kondicionet urbane parashikuar në aktet ligjore në fuqi.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 992 / prot.
18

Durrës, më 04. 11 .2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.109 datë 30.10.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Rindërtimit si rezultat i dëmit të shkaktuar nga prishja e detyruar (demolimi) e pallatit Kastrati Group dhe dërgimin e saj pranë institucioneve përkatëse për vijimin e procedurave të mëtejshme”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.10//2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

